



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2694 Prot.
3

Patos, më 20.08 / 2026

NJOFTIM

Dëgjese publike me temë:
“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2027”

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, si dhe shkresës me nr. 2694 prot., datë 20.08.2026 me lëndë: “Kërkesë për shtyrje afati për PBA-në 2027-2029, buxhtin 2027 dhe paketën fiskale të vitit 2027,

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Hënë** në datë **21.09.2026**, ora **10:00**, në Sallën e Këshillit Bashkiak Patos do të organizohet dëgjesa publike me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, grupe interesi, banorë të Patosit dhe njësive administrative, përfaqësues të bashkisë Patos, me temë: “**Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2027**”.

Këto konsultime publike synojnë realizimin e një procesi transparent mbi konsultimin e ndryshimeve në dokumentin e paketës fiskale 2027 në tre njësitë administrative Patos, Ruzhdie dhe Zharrëz.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjese publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.


KRYETARI
Fation Duro